

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

11.06.2024

Ora, 12:01

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin e kërkesës nr. 2 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali, z. Koli Bele.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S’ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK
- **Anëtarë të GNV:** A. Nelaj, A. Çanaku, A. Lekaj, A. Shytermeja, G. Mulla, A. Mersuli, T. Mersuli.

Z. I. Rusmali: Fillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative për një listë anëtarësh të grupeve të numërimit të votave, për të cilët nga kontrolli paszgjedhor i materialeve të votimit janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore. Prezent janë katër anëtarët e KAS-it, anëtari i pestë mungon me arsye të justifikueshme. Janë përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që do të thotë përfaqësojnë dhe mbrojnë kërkesën e paraqitur nga Komisioneri dhe janë do t’ju lutem shumë të prezantoheni, disa nga anëtarët e numërimit të votave që janë ftuar për të marrë pjesë në këtë seancë. Nuk janë të gjithë, por ju që jeni ju lutem prezantohuni përpara mikrofonit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Adritatik Nelaj!

Z. I. Rusmali: Ju jeni nga?

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Nga Tirana, njësia 6, KZAZ nr. 36.

Z. I. Rusmali: Nr. 16.

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Ardit Canaku, qyteti Peqin, KZAZ nr. 44.

Z. I. Rusmali: Peqin, 18. Po!

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Armando Lekaj, qyteti Vau-Dejës, KZAZ nr. 06.

Z. I. Rusmali: 3. Dakord!

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Andon Shytermeja, Durrës. Nuk e mbaj mend numrin, të më falni.

Z. I. Rusmali: Nr. 27.

Z. I. Rusmali: Të tjerë? Te mikrofonin, ju lutem se duhet regjistruar!

Z. Terion Mersuli, Devoll: Terion Mersuli, Devoll, KZAZ nr. 75

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Nr. 8.

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Gazmend Mulla, Devoll, KZAZ nr. 75.


Z. I. Rusmali: Dakord! Të tjerë nuk kemi? Edhe 1

Z. Artan Mersuli, Devoll: Artan Mersuli, Devoll.

Z. I. Rusmali: Mirë faleminderit. Fillimisht besoj do të flasë drejtoresha juridike, të na shpjegojë shkurtimisht kush kanë qenë gjetjet anëtarëve të grupit të numërimit të votave për këta anëtarë dhe eventualisht cilat janë kërkesat që ka Komisioneri për secilin prej tyre.

Znj. M. Koja: Faleminderit zoti Rusmali. Atëherë në vijim të autorizimit ligjor që Kodi Zgjedhor i ka dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për procesin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve është bërë këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit të vlerësimit të numërimit të votave. Ky proces u realizuar nga data 6 nëntor deri 26 nëntor 2023 dhe në përfundim të raportit të gjetjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 48, datë 16 maj 2024 e miratoi atë. Komisioneri nëpërmjet kërkesës nr. 2 drejtuar KAS propozon vendosjen e sanksioneve administrative ndaj disa anëtarëve të grupeve të numërimit të votave përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga këqyrja sipas lidhjes në aneksin nr. 4 të raportit. Në këto

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

kushte, ne kërkojmë kalimin e kërkesës për shqyrtim dhe vijimin e procesit të shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Mirë faleminderit! Unë do të sugjeroja të fillojmë shqyrtimin duke dëgjuar personat që janë prezent, pastaj vijojmë një nga një me të gjithë personat e tjerë të listës, sepse i kemi prezent dhe është mirë të dëgjojmë këta paraprakisht. Edhe njëherë, kush e merr fjalën nga ju i pari? Do thoni vetëm në cilën qendër votimi ke qenë numërues, për cilën qendër votimi keni qenë numërues dhe gjithshka lidhur me konstatimet e KQZ-së, se çfarë qëndrimi keni ju.

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Po, në qendrën e votimi 18790. Për sa i përket pasqyrës, ju na keni dërguar dhe një pasqyrë para disa muajsh që ne e kemi parë, jemi venë në dijeni në fakt.

Z. I. Rusmali: Ju keni qenë dhe te 186901?

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: 186901 jo. Po 01 po. Nuk e di, nuk e mbaj mend, por këtë më kanë sjellë si pasqyrë.

Z. I. Rusmali: Sepse më rezulton mua që shkeljet janë konstatuar te 186901. Jo tek 18790.

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Mund të jetë numërues tjetër, janë 11 këto. Janë 11 GNV. Unë kam këtë 18790.

Z. I. Rusmali: Dakord! Çfarë është konstatuar atje sipas jush?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Pas numërimit të kryetarëve të bashkisë, përveç orëve të gjata dhe pa ndalim, ndërkohë që fillon numërimi për këshilltarët dhe pjëstarët e tjerë që vinin, numëruesit iu shmangën këtyre gjërave dhe këto subjektet nuk para... dhe nga lodhja dhe gabime njerëzore që mund të kemi bërë. Madje ne i kemi pranuar dhe këto gabimet e vogla që mund të na kenë shpëtuar gjatë numërimit. Tre netë pa gjumë mund të kemi bërë dhe ndonjë gabim të vogël.

Z. I. Rusmali: Në vlerësimin tuaj nuk ka pasur modifikim me dashje?

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Jo, me dashje jo. Asnjëherë!

Z. I. Rusmali: Nga administrata mund të na thotë njeri konstatimin për këtë rast?

Z. E. Meta: Gjatë procesit të këqyrjes paszgjedhore kanë rezultuar për këtë grup numërimi dy problematika për dy qendra votimi 187901 dhe 186901/1. Nga argumentimet që kanë dhënë grupet e numërimit janë marrë parasysht argumentimet lidhur me gabimet e konstatuara në qendrën e votimit 1879 dhe nuk janë vlerësuar argumentat e dhëna për qendrën e votimit 186901 ku diferenca ishte në 32 vota.

Z. I. Rusmali: Sa ishte diferenca?

Z. E. Meta: 32 vota në total për të gjitha subjektet zgjedhore. Nuk është devijim për një subjekt.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Ju konsideroni 32 vota në total një diferencë të konsiderueshme. Keni gjetur shpjegim, motivim ju nga ana juaj për këtë lloj difference. Lëvizja e votave e tregon këtë indikacion lëvizjen në favor të dikujt apo kundra dikujt tjetër?

Z. E. Meta: Pikërisht... ne kemi marrë një marzh gabimi prej 5 përqind të votave të vlefshme si të thuash të pranueshme që koorespondojnë, që janë diku në 20 vota për qendër votimi si marzh gabimi të arsyeshëm. Ndërkohë të gjitha diferencat mbi 20 vota janë vlerësuar si të thuash marzh gabimi, që nuk kanë një argument juridik për të arsyetuar devijimin nga kërkesa e ligjit për saktësinë në procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave. Në rastin konkret grupi i numërimit përveç argumentave të paraqitura për lodhjen, nuk kanë paraqitur një argument tjetër që mund të shkonte në favor të tyre.

Z. I. Rusmali: Dakord! Zoti Nelaj do t'i ktheheni 1869 apo ju thoni nuk kam qenë fare aty nuk jam marrë fare me 1869?

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Nuk e mbaj mend sesi po për këtë kuti, këtu e kam emrin. 69 nuk e mbaj mend, njësoj është kjo pothuaj. Ne kemi qenë të paktën 2-3 grupe nuk kemi lëvizur fare nga vendi. Ky nuk është justifikim. Nga ana e lodhjes, gabime njerëzore, nuk e di sesi e gjykon dhe zotëria parafolës, por unë di të them që aty ka qenë një korrektesë dhe për numërimin e votave të kryetarëve, por edhe për këto subjekte që janë shumë subjekte, kemi ngatëruar diku minus, diku plus tani njerëz jemi dhe gabojmë, tani dhe pagjumësia. Një numër i madh kutish votimi.

Z. I. Rusmali: Dakord! Pse për këtë qendër votimi ju kërkoni sanksion administrativ vetëm për tre anëtarë të grupit të numërimit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Meta: Sepse argumenti i dhënë në rastin konkret ka qenë orët e vona dhe lodhja e shumtë, numri i lartë i kutive ka sjellë gabimin. Kaq ka qenë argumenti i grupeve të numërimit.

Z. I. Rusmali: Je dakord? Është një qendër votimi dhe kërkohet sanksion për tre anëtarë. Grupi i numërimit është me?

Z. E. Meta: Kaq ka qenë numri i anëtarëve për këtë qendër votimi.

Z. I. Rusmali: Me tre firma është kjo?

Z. E. Meta: Po me tre firma.

Z. I. Rusmali: Dakord, në praktikë ju keni edhe një shkresë të datës 18.01.2024 e cila ka këtë argumentimin, justifikimin le të themi për shkaqet të cilat ka pasur si të thuash mospërputhje. Ky justifikim është nënshkruar nga 11 persona?

Z. E. Meta: Gjithë grupet e numërimit të asaj KZAZ-je.

Z. I. Rusmali: Midis të cilëve dhe zoti Nelaj?

Z. E. Meta: Po!

Z. I. Rusmali: Por janë të gjithë grupet e numërimit të kësaj KZAZ-je. Janë këtu brenda dhe të tre personat., që janë edhe Klaus Shaqiri dhe Klajdi Neçi. Janë? Mirë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Klajdi dhe Klaus. Mirë! Ju nuk e gjeni të justifikueshëm të pranueshëm justifikimin e ...

Z. E. Meta: Saktë!

Z. I. Rusmali: Zoti Nelaj, në fund juve do të mbani qëndrim edhe për këtë arsytim, në fund fare apo jo? Nuk keni nevojë të flisni tani. Mirë. Kalojmë kush është afër mikrofonit tjetër? Çfarë qendre?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Përshëndetje të gjithëve. Jam Ardit Çanaku, Bashkia Peqin.

Z. I. Rusmali: Dakord, QV nr. 2272/1?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Është po e njëjta situatë. Kemi qenë në numërim. Numërues të parë, kemi nxjerrë kandidatën dhe pasi në qendër votimi nuk kishim më numërues, jemi detyruar që të rikthehemi përsëri. Duke qenë së lodhja dhe pagjumësia bëjnë punën e vet. Ndërkohë që është një diferencë prej 21 apo 22 votash, që besoj është gabim njerëzor nga ana jonë. Thjesht ju garantoj që asgjë në këtë rast nuk është bërë qëllimisht.

Z. I. Rusmali: Ju keni qenë propozim i cilit subjekt?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Partia Socialiste.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ju keni komunikuar me KQZ-në. Siç shoh unë këtu ju keni shkresë drejtuar KQZ-së me arsyetimin tuaj? Edhe komunikim me whats up.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Besoj se po, nuk më kujtohet fiks.

Z. I. Rusmali: Në rregull. KQZ-ja çfarë vlerësimi ka për këtë rast?

Z. E. Meta: Edhe në këtë rast, subjekti ka deklaruar pak a shumë të njëjtin argument. Ka qenë pa shkëputje, me orë të zgjatura pa gjumë, ka humbur përqëndrimin. Deklaron se është i keqardhur për pasaktësinë, të cilat nuk kanë pasur qëllim shtrembërimin e rezultatit. Nga administrata e KQZ-së është vlerësuar që duke ju referuar nenit 116 deri në nenin 120 të Kodit Zgjedhor, të cilat kanë përcaktuar procedurat që bëjnë grupet e numërimit, marzhi i gabimit njerëzor nuk është i justifikuar dhe argumentuar me këtë argument.

Z. I. Rusmali: Sa ishin këto diferencat?

Z. E. Meta: 23 vota në rastin konkret.

Z. I. Rusmali: Ardit, ligji parashikon dhe rregullat e KQZ-së parashikojnë edhe mundësinë e pushimit për ju. Sa është 4 apo 5 kuti numërimi?

Z. E. Meta: Jo më shumë se 10 qendra votimi.

Z. I. Rusmali: Jo më shumë se 10 qendra votimi. Pse ju me orë të zgjatura? Nuk është respektuar ky parashikim?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Për shkak se nuk kishte më numërues në qendrën tonë të numërimit, mungesa e numëruesve. Pasi partitë e tjera nuk u paraqitën dhe u detyruam që të dilnim po ne vetë për të vazhduar numërimin.

Z. I. Rusmali: Ardit, për këtë qendër votimi janë në listë edhe Enea Karina dhe Xhulio Maçi. Të kujt subjekti kanë qenë këto? Apo nuk i mban mend?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Besoj të partive të vogla.

Z. I. Rusmali: Po pse tre në këtë rast?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Për shkak të mungesës, mos gabo hem të numëruesve.

Z. I. Rusmali: Dakord. Në dokumentacionin e kësaj qendre votimi janë edhe shkresat e ardhura nga komunikimi edhe me dy anëtarët e tjerë. Janë të tre anëtarët që kanë komunikuar me KQZ-në dhe janë përgjigjur pyetjeve siç del dhe në raport për shkaqet që ata mendojnë se kanë sjellë këto pasaktësi. Mirë dhe ti Ardit do flasësh në fund, do gjykojmë në fund se sa qëndrojnë këto justifikime. Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve justifikimi i lodhjes nuk qëndron apo jo? Mirë tjetër? Kë kemi tjetër?

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Përshëndetje të nderuar! Unë jam Armando Lekaj, KZAZ nr. 6, Bashkia Vau-Dejës.

Z. I. Rusmali: QV nr. 0172. Po, Armando.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Një sqarim në lidhje me këtë situatë. Unë jam i bindur kam qenë dhe do të jem gjithmonë në respektim të ligjit dhe ky rast realisht më ngjall keqardhje me situatën. Jam një person, që në fushën time të studimit dhe synimet e mia për të ardhmen i janë dedikuar administratës, kështu që nuk bëj pjesë dhe distancohem komplet nga çdo akt jo ligjor dhe me qëllim të tillë. Për të sqaruar situatën. Kjo ishte përvoja ime e parë, e sqaroj dhe e theksoj, ishte përvoja ime e parë dhe vetëm në përgjigje dhe gjendjes dhe situatës të krijuar në atë ZAZ. Nevoja ishte e madhe, procesi kishte nevojë të shtyhej përpara dhe nuk e di nëse nga komisioni mund të ma konfirmojnë, për shkak të gjendjes së atëhershme që kishte nevojë edhe për numërues. Nevojë të jashtëzakonshme që të ecte procesi përpara. Unë jam gjendur aty si vullnetar, edhe i partive politike për të shtyrë procesin përpara. Kam numëruar për procesin edhe për votat e kryetarit të bashkisë, po ashtu kam numëruar edhe për procesin e zgjedhjeve për këshilltarët bashkiakë. Ku sidomos për këshilltarët bashkiakë ka qenë një situatë tejet edhe më e rënduar nga mungesa e numëruesve. Këtë uroj të ma konfirmojnë edhe përfaqësuesit e Komisionerit. Ajo që dua të them unë është që jam përpjekur që këtë proces realisht dhe me sinqeritetin më të madh ta çoj përpara. Shpjegimet me sa pashë, në kërkesën nr. 2, mos gabofsha të Komisionerit, drejtuar Komisionit të Ankimeve, nuk ishte justifikuar përgjigjia që është dërguar nga ana ime. Me keqardhjen më të madhe e mësova këtë. Nuk më është komunikuar as zyrtarisht nga ana e Komisionerit që nuk është pranuar arsyetimi. Ndoshta argumentimet e mia të dhëna aty, janë argumentime njerëzore, janë argumentime që ndoshta nuk i përkasin 100 përqind aspektit ligjor, por fillimisht unë e ndjej të moralshme që këto fjalë t'i them. Angazhimi im nuk ka qenë asnjëherë tjetër përpos faktit, që synimi i vetëm ka qenë të çuarit përpara të atij procesi. Për këtë jam i bindur dhe për këtë, unë e dëshmoj, jo këtu, po ku të jetë e nevojshme, me bindjen dhe sinqeritetin më të madh. Po ashtu si përvojë e parë, edhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

si vijim pune i pandërprerë, kemi përfunduar numërimin e të gjitha votave për kryetarin e bashkisë pa ndërprerje. Është bërë një ndërprerje shumë e shkurtër, në mos u gabofsha, për të vijuar më tej pastaj me numërimin e votave për këshilltarët bashkiakë. Edhe po aty kam vijuar numërimin. Unë kam qenë i njëjti, grupi i numërimit tim ka ndryshuar. Unë kam vijuar që të jem numërues si për kryetarin e bashkisë si për këshillin bashkiak. Unë kam vijuar të qëndroj aty. Përsa i përket edhe trajnimit, trajnimi ka qenë i mangët. Mua më është kërkuar numërues i parë, në mos gabofsha, për numërimin e votave për këshillin bashkiak edhe trajnimi ka qenë i mangët. Më është thënë kjo, kjo, një trajnim asnjë minutë. Se do hapet kutia do numërohen fletët e votimit dhe kaq është trajnimi. Këtë e di teorikisht se kushdo mund ta thotë këtë, se do të hapet kutia, do të numërohen fletët e votimit, por këto pasojat juridike do të duhet t'i vuaj unë tani. Një njeri të vuaj pasojat juridike, sepse kapacitetin kuptues unë e kam, dëshirën për zbatimin e ligjit e kam dhe sikur ju thashë i kam dedikuar rininë time. Të dënohem unë qoftë dhe masë administrative, apo me çfarë do lloj mase, nuk ja fal vetes parimisht.

Z. I. Rusmali: Ju keni qenë përfaqësues i cilit subjekt?

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Kam qenë për kryetar bashkie për Bashkë Fitojmë.

Z. I. Rusmali: Ju jeni vënë në dijeni nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për rezultatin konkret të verifikimit? Keni shpjegim konkret për lëvizjen e votave, i mbani mend?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Jo. Tani gjej rastin, nëse ju lutem do të mund të interpretoj në përfaqësuesit e Komisionerit se sa është totali se unë shoh disa numra plus dhe minus, por nuk e di sa është totali.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ju i keni parë, i keni marrë me shkrim?

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: I kam marrë me shkrim.

Z. I. Rusmali: Dhe keni dhënë dhe përgjigje, me duket se keni dhënë përgjigje dy herë.

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Po patjetër. E kam dërguar në të gjitha format e komunikimit si fizike dhe online.

Z. I. Rusmali: Përgjigje kanë dhënë dhe kolegët tuaj të grupit të numërimit. Pavarësisht se ata nuk janë prezent këtu. Grupi numërimit ka pasur 4 anëtarë, janë të katërt në listë. Nuk janë prezent 3 të tjerët, por nga praktika rezulton që ata kanë marrë dijeni dhe kanë komunikuar me KQZ-në për arsyetimin e tyre. Unë do të isha kurioz të di nëse mbani mend pershembull numrin e lartë të votave të pavlefshme të deklaruar nga ju, ndërkohë KQZ-ja mendon se nuk është numër i lartë. Në mos gaboj, apo është e kundërta?

Z. E. Meta: Në rastin konkret nga të 4 anëtarët e grupit të numërimit, dy kanë ngritur pretendime në lidhje me trajnimin, zotëria në fjalë dhe një tjetër. Ndërkohe numri i votave të devijuara është 24.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Vota të devijuara 24. Po tabela që është këtu që flet për vota të pavlefshme. Ju në rinumërim keni shtuar numrin e votave të pavlefshme. Nuk e ke tabelën? Ju nuk keni venë re tendencë në trajtimin e votave si KQZ? Keni venë vetëm diferencë numri.

Z. E. Meta: Po diferenca e numrit.

Z. I. Rusmali: Sepse nëse unë e lexoj drejt këtë tabelën që keni ju, mua më rezulton psh që Bashkë Fitojmë, janë zbritur 5 vota nga riverifikimi, por po 5 vota i janë zbritur dhe Partisë Socialiste nga riverifikimi. Do të thotë, nëse ka një tendencë politike për të transformuar rezultatin, tendenca do dukej te ky, te fakti që do t'i merrej konkurentit dhe do të hidhej për vete. Apo nuk rri kjo analizë?

Z. E. Meta: Nuk i kemi hyrë kësaj analize se është e pamundur të verifikosh qëllimin e devijimit të votës. Në të tilla raste nuk kemi pasur një transaksion tërësor të fletëve të votimit nga një subjekt te tjetri. Kanë qenë diferenca për të gjitha subjektet në tërësi.

Z. I. Rusmali: Mirë. Dakord

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Vetëm një shtesë të vogël. Nëse ka një gabim njerëzor, sepse me të vërtetë jam para jush me gjithë respektin ndaj jush. Nëse ka një gabim njerëzor, në këtë rast, që në rastin tim është dhe e them me plot bindje, atëherë edhe masa e vendosur nga Komisioneri besoj, nuk e di, më herët dëgjova 5 përqind e votave të vlefshme diçka e tillë. Nuk e di nëse mund të gabohet në mënyrë njerëzore 19 apo 21. Nëse gabimi im njerëzor mund të vlerësohet i tillë se është 19

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

dhe jo 21. Gjithsesi nuk dua t'i hyj kësaj pjese. Ju jeni kompetentët dhe me besim të plotë që do t shqyrtoni me ligj dhe me zemër këtë pjesë, ashtu sikurse po paraqitet. Thjesht jam i bindur që në dijeninë time, por edhe në tavolinën ku punohej, si pasojë edhe e numrit të lartë të subjekteve, ku fleta e votimit për këshillin bashkiak ka qenë listë e madhe me shumë dhe mbivendosje...

Z. I. Rusmali: Nëse ju e mbani mend sa qendra votimi, sa kuti keni numëruar ju në atë proces?

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Pafund...

Z. I. Rusmali: Ju personalisht?


Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Pafund, nga fillimi deri në fund unë kam qenë aty. As nuk më kujtohet...

Z. I. Rusmali: Nuk i keni numëruar të gjitha?

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Të gjitha jo, por edhe nëse kemi pirë një shishe ujë, e kemi pirë aty duke vazhduar procesin. Edhe nëse kam qenë numëruar i parë, kemi qenë 4 veta aty, hap kutinë, vazhdo me procedurën, ndaj votat dhe nuk është se e kam hap vetëm unë dhe kam hap votat, i kam paraqitur, i kam ndarë sipas subjekteve. Aty është punuar në grup.

Z. I. Rusmali: Pra, KQZ-ja, e kemi ne këtë statistikë? Apo e nxjerrim dot ne këtë statistikë, sa kuti votimi ka punuar secili nga këta 28 persona?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Meta: Jo!

Z. I. Rusmali: Se nxjerrim dot.

Z. E. Meta: Se nxjerrim dot, se sistemi nuk merr emrat e numëruesve.

Z. I. Rusmali: Dakord! Por gjithsesi konkluzioni është i sigurtë që në këtë KZAZ, diferencë të konsiderueshme ka vetëm kjo qendër votimi. Vetëm kjo kuti. Mund të kenë diferenca, por jo relevante.

Z. E. Meta: Edhe është e vërtetë çfarë tha zotëria, lidhur me dinamikën e procesit. Ajo KZAZ, është mbikqyrur nga KQZ-ja për shkak të fillimit me vonesë, le të themi të procesit të numërimit. Është ndikuar nga ana jonë në mënyrë që të plotësoheshin afatet ligjore.

Z. I. Rusmali: Mirë. Dakord!

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Përshëndetje! Unë jam Andon Shytermeja nga qyteti i Durrësit. Për mua ishte po ashtu përvoja e parë e ...

Z. I. Rusmali: 14205 qendra e votimit.

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Po! Për mua ishte hera e parë që ndodhesha në numërim. Kanë qenë orët e gjata deri në orët e para të mengjesit edhe pushimi që kemi pas ka qenë i shkurtër, nuk kishim kush të na zëvendësonte që pushimet t'i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

kishim të gjata. Besoj dhe jam i bindur që ai gabim që ka ndodh nga ana ime ka qenë njerëzore dhe nga lodhja e tepërt që kam pas, sepse siç e thashë, ishte hera e parë për mua. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Po, çfarë arsytimi ka KQZ-ja lidhur me..

Z. E. Meta: Edhe në rastin konkret, grupet e numërimit për këtë KZAZ, numri i votave të devijuara në këtë rast është 39 vota, të cilat në këndvështrimin tonë janë një numër i madh.

Z. I. Rusmali: Keni lexuar ndonje tendencë te këto vota?

Z. E. Meta: Jo ndonjë gjë domethënëse.

Z. I. Rusmali: Andon, ti ke qenë i informuar për rezultatet, ka komunikuar KQZ-ja me ty?

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Më ka lajmëruar nëpërmjet një poste domethënëse...

Z. I. Rusmali: Nuk u ke kthyer përgjigje?

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Po u kam dërguar email! .

Z. I. Rusmali: E kam këtë? Se kam këtë...

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Po kam dërguar me email përgjigje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Mirë përgjigje kanë kthyer edhe Erdi Bejdo dhe Dorian Allkaj në mos gaboj. Po, edhe Doriani. Mirë dakord. Kalojmë pak më tutje. Nga Devolli, shkojmë pak në Devoll. Lironi hapësirën për kolegët.

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Po flas unë, Gazmend Mulla. Përshëndetje të gjithëve. Kam qenë anëtar i grupit të numërimit të qendrës së votimit nr. 4016, KZAZ nr. 72. Për të mos e zgjatur ashtu siç dëgjova dhe nga parafolësit, të njejtat situata besoj se i kanë pasur të gjithë anëtarët e komisionit të numërimit në lidhje me vështirësitë e procesit, por gjithsesi kjo nuk përbën ndonjë justifikim të plotë, të themi që jemi plotësisht të pafajshëm. Megjithatë unë e them që vetë, megjithëse jam në moshë rreth të 60-ve, e kisha për herë të parë që merresha me komisionin e numërimit dhe më mungonte të them të drejtën përvoja në këtë aspekt. Unë jam me profesion mësues dhe betohem para ligjit që në jetën time kurrë nuk jam marrë me manipulime. Kurrë në jetën time, nuk ma lejon profesioni e brumosur në kulturën time ajo e qena e drejtë si fëmijet. Gjithsesi faktet janë fakte, nuk mund të dalim asnjëherë kundra fakteve. Nuk mund të pretendojmë që unë jam profesionist në këtë fushë, se nuk jam profesionist. Jam profesionist në fushën e arsimit dhe aty nuk mund të më lejohet të gaboj. Ndjehem i gabuar nga shqyrtimi që ka bërë Komisioneri Zgjedhor, por jo fajtor. E them me bindje këtë për arsyen e vetme se në tre pikat që referohet Komisioni Zgjedhor për gjetjet, shkeljet. Te pika e parë, thuhet që kemi një mospërputhje të fletëve të votimit të papërdorura dhe të fletëve të votimit të dëmtuara dhe mospërputhje të fletëve të votimit të pavlefshme dhe fletëve të votimit të vlefshme dhe gjithsej këto përbëjnë numrin 16. Fakti po është, besoj shumë i vërtetë, sepse në këtë qendër votimi ose në këtë kuti numërimi, ne hasëm problematikën që mungonin të gjitha procesverbalet e komisionit të qendrës së votimit nr. 4016 nga

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

anëtarët të pafirmosura, të paplotësuara procesverbalet fare. U gjendëm në një situatë që nuk dinim si të vepronim. Gjithsesi për momentin kaq gjë e dinim që duhet të njoftonim anëtarët e KZAZ-së, kryetarin e KZAZ-së. Kemi çuar dorën, ka ardhur njëri prej tyre, na ka orientuar në mënyrë verbale se si të vepronimin, megjithëse nuk u muar vendimi menjëherë, në mënyrë të menjëhershme. Çfarë biseduan ata, në fund fare na thanë që vazhdoni numërimin e votave dhe ne vazhduam numërimin e votave. Gjithsesi e them dhe këtë faktin tjetër që ashtu siç e përmban Kodi Zgjedhor, që në grupin e numërimit, numërojnë jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10, unë jam fare i qartë se ne kemi numëruar 13 kuti. Sepse edhe bëmë një farë replike aty me ata anëtarët e tjerë të grupeve të tjera, diçka unë 13 e mbaj mend në fakt. Është edhe diçka tjetër, i nderuar zoti përfaqësues i KAS, është një lloj demotivimi në ato momente, se në Devoll ka ndodhur diçka e tillë. U numëruan kutitë për kryetar të bashkisë dhe pasi mbaron procesi numërimit për kryetar, fillojmë për këshilltarët. Këtu kuptohet bie interesi fare, lodhja të gjitha ato pastaj janë faktorë dytësorë që shpien në këto pasoja. Gjithsesi edhe njëherë e përsëris që ne kemi vepruar në lidhje me problemin e parë sipas ligjit. Thjesht kemi kërkuar konsulencën e anëtarëve të KZAZ-së. Na është thënë në mënyrë verbale që të vazhdojmë dhe kemi vazhduar procedurat ashtu siç... Për pikën tjetër se janë tre konstatime, mungojnë mospërputhje të fletëve të votimit të subjekteve politike BF dhe PDIU. Unë për veten time nisur nga parimi im individual, unë isha përfaqësues i Partisë Socialiste dhe si i tillë kam administruar vetëm votat ose fletët e votimit të Partisë Socialiste. 87 në këtë qendër votimi nga 87. Për pjesën tjetër nuk mund të flas, nuk di si mund të shpjegohem, si ta argumetoj, si kanë lëvizur këto nga një forcë politike, në një forcë politike tjetër? Megjithëse aludimi është fare i qartë. Kujt i intereson e ka bërë këtë punë. Por, unë për veten time, flas në mënyrë personale kam administruar vetëm

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

votat e Partisë Socialiste dhe në këtë qendër votimi kanë qenë 87 vota të Partisë Socialiste nga 87.

Z. I. Rusmali: Gazmend, këtu jeni 3 nga 4 anëtarët. I katërti, e katërta, nuk e di çfarë është ndodhet jashtë shtetit prandaj nuk ndodhet këtu.

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Personalisht nuk e njoh.

Z. I. Rusmali: Këtë qendër votimi e keni numëruar ju të katërt. Nëse ka pasur lëvizje, ka qenë lëvizja në syrin e ju të katërtëve, nuk themi dot që unë ruaj vetëm vathën time. Ju jeni aty për të ruajtur të tërën.

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Unë e thashë që në fillim në fjalën time, betohem me sinqeritetin tim më të madh që në dijeninë time nuk është bërë. Aty mund të jetë bërë ndonjë ngatërresë për vetë faktin se u shkaktua rrëmuja, kaosi që në fillim. Për vetë faktin se mungonin të gjitha procesverbalet, qenë të paplotësuara fare, pale të firmosura e të vulosura jo e jo. Që në atë moment filloi ajo, si duket në atë moment kur janë hapur fletët e votimit aty mund të jenë ngatërruar, nuk mund të them. Pastaj si ka mundësi që unë të shoh se çfarë votash ka anëtari tjetër? Ai që numëron votat, kryetari i QV shfaq fletën e votimit në monitor, thotë emrin e subjektit, në momentin që thoshte Partia Socialiste unë e merrja dhe e shikoja përpara vetes. Thoshte emrin e subjektit tjetër e merrte përfaqësuesi. Një pjesë e votave të pavlefshme, siç ishte vendosur në fillim me marrëveshje vendoseshin në cep të tavolinës. Flas me atë pastërtinë time.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Te votat për subjektet, ju keni qenë sekretar i KZAZ-së. Do të thotë procesverbalin e keni plotësuar ju? Kontestime ka pasur gjatë numërimit të këtyre votave?

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Jo!

Z. I. Rusmali: Nuk figurojnë kontestime.

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Jo, madje, edhe diçka edhe një detaj. Kjo mesa më kujtohet, kjo ishte kutia ose e parafundit ose e fundit, nuk kishte të bënte. Rezultatet pothuajse kishin dalë. Nuk përbënte asnjë kërcënim apo indicie për diçka tjetër.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ja të dëgjojmë njëherë, kolegët kanë ndonjë gjë për të shtuar, apo i qëndroni kësaj analize?

Z. Terion Mersuli, Devoll: Të gjitha ato që tha Gazmendi janë të vërteta. Thjesht lëvizja e votave, unë nuk e mbaj mend sa ka qenë numri i saktë. Mund të jenë ngatërruar gjatë listimit që ne bënim, mund të jenë bashkuar me një subjekt tjetër.

Z. I. Rusmali: Numri ka qenë 20 vota në mos gaboj.

Z. Terion Mersuli, Devoll: Se një person në tavolinë mbante 3-4 subjekte

Z. I. Rusmali: I kanë ikur të 20-ta një subjekti dhe i kanë shkuar të 20-ta një subjekti tjetër?

Z. Terion Mersuli, Devoll: Po, kanë qenë në listim, jo votat e ngatërruara.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Po Gazmend!

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Do të thoja për të përforcuar mendimin, që ne ramë dakord që në fillim që ata që.., ne anëtarët që përfaqësonim subjektet politike që kishin më tepër vota, detyrimisht do të administronim vetëm subjektin tonë. Kurse partitë e vogla, detyrimisht do të merrnin, meqenëse kishin më pak vota, do të administronin 2-3 subjekte. Këtu mund të jenë bërë dhe ngatërresa. Manipulim nuk mund ta quaj dot, ngatërresa po.

Z. I. Rusmali: Dakord! KQZ-ja çfarë opinioni ka, çfarë analize ka në lidhje me këtë qendër votimi?

Z. E. Meta: Lidhur me veprimet e grupit të numërimit, nga përgjigjet e grupit të numërimit, më saktë nga dy anëtarë është sjellë në vemendje që janë konsultuar me KZAZ-në, që referuar dhe përcaktimeve të ligjit 116120 të Kodit Zgjedhor këto duhet të ishin vota të kontestuara dhe duhet të ishin evidentuar nga KZAZ-ja. Në rastin konkret qoftë në librin e protokollit të mbledhjeve qoftë në procesverbalin e konstatimeve nuk është evidentuar asnjë element i tillë, prandaj e kishim shumë të vështirë të vinim në balancë, le të themi, pretendimet e grupit të numërimit me veprimet e KZAZ-së.

Z. I. Rusmali: Marrim në shqyrtim numërimin e qendrës së votimit 1317. Nuk kemi njeri tjetër që është këtu? Të tjerët mungojnë, apo jo? Qendrën e votimit nr. 1317, çfarë gjetje ka KQZ-ja për këtë qendër votimi? Nuk ka gjë! Nuk është në listë kjo?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Pse ma keni dhënë? Po është! Dakord, Kruja! Në këtë qendër votimi kanë qenë Andi Daci, Arlind Babasi, Ergys Kaziu dhe Gazmend Kaziu.

Z. E. Meta: Diferenca e votave në këtë qendër votimi për këtë grup numërimi është 48. Është numri më i lartë i konstatuar nga të gjitha devijimet.

Z. I. Rusmali: Te subjektet?

Z. E. Meta: Po! Pretendimet e grupit të numërimit kanë qenë se votat e subjekteve kanë qenë ngjitur me njëra-tjetrën dhe kjo ka sjellë ngatërresa të numrit të subjekteve që përkon dhe reflektohet dhe në procesverbalin përfundimtar të mbajtur nga grupi numërimit dhe pretendojnë që është një gabim njerëzor nga mbingarkesa.

Z. I. Rusmali: Këtu i janë shtuar një numër i konsiderueshëm votash një subjekti politik. Po a i janë hequr ndonjë subjekti tjetër? Domethënë kemi shtesë në tabelë në raport me faktin? Këtë tabelën që kam unë?

Z. E. Meta: Pra, në rastin konkret konstatohet që ka një devijim prej 38 votash. Janë shtuar nga grupi numërimit 38 vota, më fal i janë hequr Partisë Socialiste 38 vota dhe i janë shtuar subjektit Partia Agrare Ambientaliste.

Z. I. Rusmali: Në grup në total?

Z. E. Meta: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Mirë dakord! Gjë tjetër për këtë kemi ndonjë? Për këtë nuk kemi pyetje. Dakord, kalojmë te qendra e votimit nr. 2069 Tirana. Gerald Çeça, Mario Myftaraj dhe Ardit Billaj. Tre këtu, nuk ka qenë i plotë grupi numërimit?


Z. E. Meta: Ka qenë me tre anëtarë. Vetëm një nga anëtarët e grupit të numërimit ka kthyer përgjigje.

Z. I. Rusmali: Dakord! Cila është situata këtu? Çfarë diferencash na rezultojnë?

Z. E. Meta: 23 vota në total. Ndërkohë anëtari i vetëm i grupit të numërimit që ka kthyer përgjigje ka thënë që nuk është qëllimi i tij për të gabuar, për të vlerësuar gabim numrin e votave. Nuk ka dhënë asnjë argument tjetër.

Z. I. Rusmali: Unë nuk arrij ta dalloj ku është, ku ka ndryshuar, cili është...dakord! Dakord, këtu ka ndryshim edhe të totalit të votave. Po si shpjegohet ndryshimi i totalit? Jashtë, kanë futur në tabelë më shumë seç janë realisht, apo jo? Kanë ikur 7 vota. Gabim 7 vota dhe dakord e qartë. Në këtë rast.., se zhvendosja nuk është në bllok, por ka një shpërndarje. Shënime në procesverbal nuk ka pasur. Dmth këtu është e vështirë të zbulohet ndonjë tendencë? E keni ndjekur, apo? Ju kaq keni numëruar në fakt. Nuk keni numëruar totalin që kështu ju e keni të pamundur të ndiqni si të thuash performancën e këtyre tre personave. Mirë kalojmë te 4455/1 në Vlorë. Sebastian Guçi, Klevis Kaso dhe Fation Denaj. Klevisi ka dërguar email në KQZ ka thënë që për motive që ka shpjeguar këtu, nuk është i disponueshëm për zhvillimin e kësaj seance, por nuk ka dërguar përfaqësues. Ka pasur mundësi që të dërgonte përfaqësues në emër të tij që të jepte shpjegime edhe të mbronte pozicionin. Gjithsesi KAS është gjithmonë i detyruar ta zhvillojë seancën edhe në mungesë dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

të shqyrtojë çështjen pavarësisht prezencës. Cili është konstatimi juaj në rastin e kësaj qendre votimi?

Z. E. Meta: Për këtë qendër votimi, të tre anëtarët e këtij grupi numërimi, se është numëruar me tre anëtarë, mesa evidentohet. Dy nga anëtarët e grupit të numërimit nuk kanë kthyer përgjigje, vetëm Klevisi ka kthyer përgjigje, i cili ka deklaruar që kjo ka qenë kutia e fundit ose parafundit që kanë numëruar duke pretenduar që kanë pasur 48 orë papushim dhe ka qenë thjesht një lodhje. Nuk konstatohet devijim në grup.

Z. I. Rusmali: Diferenca këtu është...

Z. E. Meta: 23 vota.

Z. I. Rusmali: 23 vota, por statistikisht ju e konsideroni të madhe?

Z. E. Meta: Janë në një kuti.

Z. I. Rusmali: Një kuti. Dakord, ja e kemi këtu diferencën. Vota të pavlefshme pas verifikimit kanë dalë 9 nga 0 që janë regjistruar në numërim. Pastaj ka zhvendosje me minus, ja heq një subjekti 11 vota, i janë shtuar një subjekti tjetër 6 vota. I janë shtuar 1, i janë shtuar 3. Ka diferenca që nuk shpjegojnë tendencë. Janë bërë si lëvizje të çrregullta. Janë shtuar 2, janë shtuar 7. Në fakt lëvizja po ta shohësh kështu është masive, por është kaotike.

Z. K. Beke: Nuk është se ja kanë marrë një subjekti...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Meta: Përgjithësisht nga të gjitha gabimet e konstatuara, hiq 2-3 qendra votimi, për çdo subjekt ka pasur një mangësi le të themi.

Z. K. Bele: Doja ta bëja dhe më parë këtë pyetje. A kemi një dallim midis situatave ku janë hequr 20 vota ose janë rivlerësuar 20 vota? Se heqje duket sikur i ka marrë votat në kurriz. Pra, janë rivlerësuar, le të themi një numër “x” votash, statistikisht thoni ju i pamundur dhe është një lëvizje *unblock* thoni ju, i një subjekti. Rasti ku ka 2 plus 3, 4, 7 vota apo 6, pra kush është diferenca midis këtyre gjërave? Sepse në logjikë të parë duket sikur ka një ndryshim midis një lëvizje teke, të shtyn të besosh që mund të ketë një qëllim dhe një lëvizje të çrregullt që të krijon një perceptim tjetër. Komenti juaj? A kemi një dallim midis këtyre dy situatave?

Z. E. Meta: Normalisht që ka një dallim, sepse siç e thashë pak më parë, në tërësi ka procesi i verifikimit paszgjedhor, kalimet le të themi diferencat *unblock* nga një subjekt te tjetri janë të pakta, minimaliste dhe gabimet ose pasaktësitë më të mëdha të konstatuara janë të kësaj tipologjile, le të themi, ku ka devijime qoftë në klasifikimin e fletës së votimit nga e pavlefshme në të vlefshme apo në devijime individuale për çdo subjekt zgjedhor që është në fletën e votimit. Rasti i qendrës së votimit të Krujës është një nga shembujt *unblock*, nuk ka patur raste të tilla të ngjashme për çdo qendre votimi që i është nënshtruar këqyrjes.

Z. K. Bele: Edhe një pyetje po këtu. Në eksperiencën tonë, kur KAS ka drejtuar procesin e rinumërimit në 2 zgjedhjet e fundit dhe janë bërë disa raste në kuptimin e kutive kanë qenë dhe masive si kuti të marra. Unë kam konstatuar, nuk e di dhe kolegët, ndoshta ndajnë të njëjtin mendim, por kemi pasur një situatë ku në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

vlerësimin ose rivlerësimin nga KAS të votave të pavlefshme, të votave të konsiderueshme të pavlefshme apo votave të vlefshme të konsideruara të pavlefshme, kemi pasur rastin kur praktika jonë, ka qenë ndonjëherë e ndryshme. Për ta ilustruar, dikur në grupet e numërimit, ka pasur qasje shumë strikte në kuptimin që edhe një vizë e vogël nga një grup, në marrëveshje e kanë konsideruar të pavlefshme. Në një kohë kur ne si KAS kemi thënë që vullneti është i qartë, ka identifikim të subjektit, pra kemi pas dhe ne raste kur kemi bërë ndryshim të praktikës, duke u sjellë si një grup numërimi superior ose i një shkalle më të lartë. A mendoni se ka raste të tilla kur këto pavlefshmëri të konstatuara janë si pasojë e këtyre lloj gabimeve? Pra, po themi që një fletë ka pas njollë dhe mua më kujtohet debati që ne bënim me numëruesit është e pavlefshme, ndërkohë që ajo dukej që ishte një njollë kalimtare boje, apo vula e dytë ishte jo e dukshme dhe ngrihej pretendimi nuk ka vulë, nuk ka vulë. Pra, ne kemi pasur disa nga këto situata. Nuk e di ju i konstatoni të tilla?


Z. E. Meta: Në rastin konkret, jo për këtë që po flas, për procesin e këqyrjes paszgjedhore, ne i jemi referuar gjithmonë vendimit të Komisionit Rregullator për vlefshmërinë e fletëve të votimit dhe çfarë është tipologji e votave të pavlefshme është kur është votuar më shumë se sa një subjekt zgjedhor në fletën e votimit.

Z. K. Bele: A ka sjellë kjo për pasojë rivlerësim të votave të cilat mund të jenë konsideruar të pavlefshme sipas këtij standarti që unë permenda?

Z. E. Meta: Të procesit të këqyrjes?

Z. K. Bele: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Meta: Të gjitha janë rivlerësuar.

Z. K. Bele: Pra, kur themi 9 vota të pavlefshme, a ishte ky rasti kur 9 vota janë konsideruar të vlefshme?

Z. I. Rusmali: Po ishin vlerësuar të vlefshme, por ishin shpërndarë.

Z. K. Bele: Pra, nuk po gjykoj, se nuk ka lidhje me subjektin. E kam te metodologjia. A mendoni që në rivlerësimin e këtyre votave në këtë rast apo në raste të ngjashme mund të ketë pasur ndryshime për këtë shkak? Pra, kuptimi ndryshe i vendimit Rregullator, rivlerësimi ndryshe?

Z. E. Meta: Normale që kjo ekziston, për sa kohë pavlefshmëria është si të thuash klasifikimi nga e pavlefshme në të vlefshme, ka edhe pak subjektivizëm në vetvete domethënë automatikisht ndikon edhe në proces.

Z. K. Bele: Po, faleminderit.

Z. I. Rusmali: Nëse mund të bëj një pyetje, nuk e di kush mund të përgjigjet nga ju, nga eksperiencia juaj si numërues, nga thëniet këtu na rezulton që në proces numërimi nuk ka pasur kontestime. Dini ju ta thoni pse ka ardhur kjo? Apo nuk kanë qenë vëzhguesit e subjekteve fare prezent kur ju keni bërë numërimin? Pa pasur prezencë vëzhguesish?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Ka pasur vëzhgues. Mesa më kujtohet ka pasur vëzhgues.

Z. I. Rusmali: Dakord. Domethënë auditori ka qenë dakord me vlerësimin tuaj? Apo lëvizjet në këto vota kanë ndodhur gjatë përpilimit të tabelës. Tabelën ju ja demonstroni sipas procedurës, ose ja lexoni? Nuk e di, si e ka procedura?

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Gjithmonë në përfundim të tabelës të gjitha subjektet politike, qoftë dhe vëzhguesit edhe përfaqësuesit e partive politike edhe ata që ishin në listë për këshilltarë ishin të pajisur me tabelën, të gjithë pa përjashtim. Të gjitha në 49 qendra votimi të Devollit, në mos gaboje, të gjitha subjektet dhe vëzhguesit, të gjitha.

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Sa për sqarim të nderuar, në dijeninë time, në KZAZ-në ku kam shërbyer si numërues nuk ka pasur subjekt zgjedhor pa përfaqësues dhe jo vetëm një. Prania e auditorit nga momenti para fillimit deri kur ka përfunduar çdo lloj shpallje, ka qenë me përfaqësues nga të gjitha subjektet. Auditori ka qenë i mbushur me përfaqësues dhe në dijeninë time ka pas përfaqësues jo vetëm të subjekteve kryesore politike, por edhe të subjekteve të mesme, të vogla, nuk po i klasifikoj se nuk kam dijeni për t'i klasifikuar. Po ashtu edhe procesverbali i mbylljes së numërimit, çdo gjë është kaluar te monitori ku kemi bërë deklarinimin e votave.

Z. I. Rusmali: Dakord! Gjatë kohës që keni qenë ju në numërim, nuk po them në këto qendra votimi se ju nuk e mbani mend, po gjatë procesit tuaj të numërimit, ka pas incidente të çfarëdolloji në ambjentet e... na e shpjegon dot?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Përshëndetje, kur ne mbaruam numërimin e votave të kryetarit, u telefonuam nga persona të tjerë, pasi ka pasur incident, të paktën në zonën tonë, qyteti i Peqinit, ku kam pas...

Z. I. Rusmali: Po në ambjentin tuaj brenda?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Nuk e di nëse ka ndodhur brenda ambjenteve, apo jashtë ambjenteve dhe kjo solli mungesën e numëruesve të dytë, që ishin përcaktuar për numërimin e anëtarëve të këshillit bashkiak.

Z. I. Rusmali: Po ju vetë, çfarë bëtë? Ndërpretë punën? Çfarë ndodhi me ju në këtë moment?

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Unë kam shkuar kur incidenti kishte përfunduar, nuk kam qenë prezent.

Z. I. Rusmali: Dakord! Po!

Z. E. Lako: Kam unë një sqarim dhe pyetje për administratën. Nga vëzhgimi që i bëjmë praktikës që ka ardhur këtu në KAS. E para, praktika çfarë vë re unë, shkresa përcjellëse dhe kërkesa dhe vendimi sikur plotësojnë njëra-tjetrën. Vendimi vetë ka disa raporte bashkëlidhur që miraton ca gjetje apriori. Tek pika 2 i kërkon Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të vendosim disa sanksione administrative. Nëpërmjet kësaj, se nuk del tek baza ligjore, kuptojmë që flasim për sanksione jo për masa disiplinore dhe pastaj nëpërmjet shkresës përcjellëse sqarohet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

që këto sanksione të vendosen në bazë të pikës 1, të nenit 171 dhe me këtë masë. Mos duhet të ishte pak më e qartë praktika, më e plotë dhe më e saktë që minimalisht për këto shkelje që kanë ardhur të jetë e referuar se cilat janë kundravajtjet administrative të kryera. Kjo, sepse po ta shohim kështu në bllok, pak a shumë është i njejti shpjegim që ka disa gabime, se edhe pjesëmarrësit për të cilët propozohet vendosja e sanksioneve, shpjegimet i kanë të karakterit që “nuk e kanë bërë me qëllim”. Ajo nuk diskutohet se Komisioneri nuk ka gjetur shkelje penale. Këtu jemi duke diskutuar për shkelje administrative. Pra, pretendohet se ka disa shkelje administrative nga ana juaj dhe këtu jemi për të provuar se janë konsumuar si shkelje administrative? A janë të mbështetura dhe shpjegimet përkatëse. Pra, nuk flasim për qëllimin, që është bërë me qëllim kjo shkelje. Po flasim se cilat janë shkeljet konkrete dhe çfarë pretendohet nga ana juaj. Kështu unë për administratën them që duhet të ishte pak, për këta që është propozuar sanksion, më e përcaktuar, më e qartë. Cila është kundravajtia përkatëse administrative e konsumuar për secilin nga këta. Këtu nuk po flasim as për vepër penale, as për masë disiplinore. Flasim për sanksion administrativ dhe ka një masë nga tre mijë deri në nëntë mijë që është e gjerë. Dmth në këtë keni ndonjë tipologji ju, se pse këta janë përcaktuar për vendosje sanksioni? Cili është kundërshtimi me gjithë këta të tjerët që kanë bërë... pak a shumë është një tipologji shpjegimi që “kemi qenë të lodhur në proces” dhe ka një gjetje që lëviz një numër diku tek 20, 20 e ca është mesataria, pra, pse këta, cila është shkelja e pretenduar? Se pjesa e vlerësimit të rinumërimit, ne siç e tha dhe një koleg tjetër këtu, ka të bëjë pak dhe me vlerësimin e votës nga një grup numërimi tek një tjetër. Pra, këta në procesin e asaj qendre votimi ka pasur një vlerësim të ndryshëm? Cila është tipologjia që jeni mbështetur ju që keni propozuar pikërisht këta për sanksion dhe jo të gjithë këta të tjerët që pak a shumë kanë të njejtën shkelje? Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Meta: Atëherë, i nderuar! Në raportin me gjetjet e këqyrjes së verifikimit paszgjedhor, është përcaktuar metodologjia me të cilën është vepruar nga administrata e KQZ-së, lidhur me këtë proces. Tërësia e dokumentacionit,, edhe tabelat dhe koorespondenca me anëtarët e GNV-ve janë pjesë përbërëse e raportit. Ajo çfarë është sjellë tek ju është pasaktësia e veprimeve të këtyre grupeve të numërimit lidhur me procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave. Pra, në rastin konkret është e përcaktuar si të thuash, veprimi konkret që kanë kryer, nga pikëpamja administrative si pasaktësi anëtarët e GNV-ve. Nuk rezultojnë të jenë përsëritës. Gjithashtu dhe në procesin e miratimit të raportit qoftë nga Komisioneri dhe ne si administratë është bërë vlerësimi që nuk kanë pasur një qëllim penal, për sa i përket atyre, nuk është vërtetuar, le të themi.

Z. I. Rusmali: Ajo që na shqetëson ne dhe na ka shqetësuar dhe herë të tjera është fakti që ju vendosni një kriter sasior, i cili mund të mos jetë domethënës për shkeljen. Filtri juaj është aritmetik, ndërkohë që filtri juaj duhet të jetë arsyetim logjik. Ka shkelje të cilat tregojnë një veprim me dashje, ka shkelje që tregojnë përgjumie. Ka shkelje që tregojnë paaftësi, secila shkelje ka domethënien e saj. mund të jenë të mëdha, mund të jenë të vogla por, domethënien e kanë. Ju nuk i konsideroni si të tilla, ju i konsideroni si numra. Çfarë është mbi 20 vota është shkelje që meriton ndëshkim dhe çfarë është nën 20 vota nuk meriton ndëshkim. Ndërkohë që arsyetimi ynë nuk përputhet me këtë. Ne si rregull, nuk përputhemi me këtë lloj arsyetimi. Ne duam të shohim se kush është si të thuash... Ne nuk kemi nevojë të provojmë me jashtë çdo lloj dyshimi, sepse procesi administrativ nuk provon jashtë çdo lloj dyshimi. Procesi administrativ, mjaftohet edhe me gjurmën e shkeljes, me një indikacion të shkeljes, atje ku kemi zhvendosje në bllok, ne kemi indikacion për shkeljen. Kur kemi mospërputhje shifrash që nuk tregojnë tendencë, nuk tregojnë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*


vullnet, nuk tregojnë qëllim, mund të jetë shpjegimi më i besueshëm lodhja. Atje ku shifrat janë kaotike, shpjegimi më i besueshëm mund të jetë paaftësia, mirëpo në rast se shpjegimi më i besueshëm është lodhja, shkelja edhe falet. Në rast se shkelja më e besueshme është paaftësia, KQZ-ja nuk vendos sanksione, por ajo merr masa që këta persona të mos jenë më administratorë zgjedhësh. Pra, reagimi është i ndryshëm në raport me konkluzionin. Ndërkohë që ndëshkimi për shkak të një kriteri sasior, nuk na ndihmon në proces, asnjërin palë. As ata, as ju, as ne! Kriteri sasior nuk ka domethënie, s'ka asnjë domethënie. Vendos këtu tavanin, ose dyshtemenë dhe eci përpara. Kjo na krijon ne vështirësi, prandaj po përpiqemi të thellohem te gjërat. Po bëj dhe një pyetje të fundit se nuk besoj se do të kemi më pyetje. Ju verifikimin paszgjedhor e keni kryer., u bë kaq kohë, apo jo? materialin zgjedhor e keni asgjësuar, apo e keni ende?

Z. E. Meta: Fletët e votimit janë në procesin e asgjësimit, ndërsa materialet zgjedhore, procesverbali sipas kodit ruhen...

Z. I. Rusmali: Ato që ruhen, se jo të gjitha ruhen, apo jo? Dakord! S'kemi pyetje të tjera! Na thoni tani përfundimisht, çfarë kërkon secila palë dhe çfarë kërkon KQZ-ja! Shkurtimisht, secili nga ju!

Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Përshëndetje! Nuk dua të justifikoj më asgjë, është ajo që thatë ju që pak autike është kjo gjë. Unë jam subjekt i Partisë Socialiste faktikisht dhe po shoh këtë renditjen. Bashkimi për Fitore ka marrë 2 vota më shumë, Partia Demokratike ka marrë 3 vota më shumë. Kjo do të thotë që ne, se jemi 18 subjekte, ose unë do të mbaja subjektin të cilin përfaqësoja dhe këto të tjerat...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. I. Rusmali: Ne nuk jemi dakord as me këtë, se ju jeni aty jo për partinë tuaj, por jeni aty për procesin. I përkisni palëve kundërshtare që duke kontrolluar njëri-tjetrin, të bëhet i rregullt. E kuptojmë që është vendosur praktikë që secili ruan të vetat, por është praktikë që ne nuk e mbështesim dot, sepse interesi i procesit zgjedhor është që duke ruajtur njëri-tjetrin, të mbroni të gjitha votat.

Z. K. Bele: Doni të thoni që nuk keni pas qëllim?


Z. Adriatik Nelaj, Tiranë: Qëllim jo, asnjë qëllim të keq, me asnjë subjekt. Faleminderit!

Z. Ardit Çanaku, Peqin: Përshëndetje përsëri! Asgjë në atë proces numërimi nuk është bërë qëllimisht. Me sa po shoh dhe shifrat, të paktën në listat tona rezultojnë se janë shtuar te Partia Socialiste 21 dhe janë hequr Partisë Republikane 22. Besoj se kjo ka ndodhur gjatë numërimit, kur ne vendosnim të gjitha votat për secilën parti dhe besoj se ka ardhur për shkak të ngatërresës, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit, tjetri!

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Dëshiroj që në përmbyllje të them dy fjalë, sidomos në lidhje me 5%. Nëse njerëzore konsiderohet me 20, apo 5%, pse të mos konsiderohet edhe me 6%, apo pse të mos konsiderohet edhe me 21, apo 24, apo nuk e di. Mbetet në vlerësimin tuaj. Nëse njerëzoria ime ka një kufi 5%, atëherë pas 5%, unë çfarë mund të jem, nëse nuk jam më njerëzor?! Për këtë, unë me bindjen time të plotë, këtij procesi do t'i shkoj deri në fund se jam i bindur për vehten time, për pafajësinë që kam. Unë kërkoj pafajësinë, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. Gazmend Mulla, Devoll: Të them të drejtën, ndihem shumë i qetë, sidomos pasi dëgjova këtu, argumentet edhe të përfaqësuesve të Komisionerit dhe tuajën. Është e vërtetë ajo që ju thatë aq saktë që lodhja, apo paaftësia kanë bërë të mundur që të kemi këtë pasojë. Flas me sinqeritet të plotë që po, këtë shpresoja të gjeja tek ju, këtë gjeta. Kërkoj falje, ju falenderoj dhe ju garantoj se në qoftë se do të jem pjesë e GNV një herë tjetër, tek unë nuk do të gjeni asnjë gabim, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Ju jeni i njeiti grup, nuk është nevoja të flisni. Atëherë dhe kolegu tjetër të na thotë edhe ai diçka!

Z. Andon Shytermeja, Durrës: Kërkoj falje, se ju thashë se ishte hera e parë për mua dhe gjatë kohës që jam ulur në tavolinën e numërimit, aty më kanë treguar edhe se si funksionon pjesa e numërimit të votave, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Po keni dhe diçka për të shtuar?

Z. Armando Lekaj, Vau i Dejës: Një sqarim të vogël lidhur me termin pafajësi, se po referohem me emocionin dhe sinqeritetin e termit, por jo në termin e duhur, në mirkuptimin për të kuptuarin se çfarë ka ndodhur dhe se ku qëndroj si pozicion në gjithë këtë situatë, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Dakord, faleminderit! KQZ-ja, çfarë opinioni ka?

Znj. M. Koja: Atëherë, ne kërkojmë që të vijohet nga ana e KAS-it me marrjen e sanksionit për anëtarët e grupeve të numërimit, sipas kërkesës së Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. K. Bele: Nuk ka ndonjë reflektin, në lidhje me rastet që u referuan, që janë jo numerikisht unik? Pra, ju mendoni se dhe kur ka shmangie të vogla përseri do të ketë sanksione?

Znj. M. Koja: Po, edhe kjo është evidentuar në raportin me provat që i janë vënë në dispozicion KAS-it. Ne e dijmë faktin që janë lëvizje të cilat nuk është se kanë qenë në bllok ose që të kenë ndikuar në ndonjë mënyrë.

Z. I. Rusmali: Po në lidhje me masën e sanksionit, sepse ju në kërkesën me shkrim keni dhënë diapazoni i plotë i masës. Keni opinion për masën me të cilën duhet të sanksionohen këta njerëz?

Z. E. Meta: Referuar rrethanave dhe pretendimeve që kanë ngritur anëtarët e grupeve të numërimit, rekomandojmë masën minimale me tre mijë lekë.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ju faleminderit! KAS i konsultuar në vend, konsideron që trajtimi i kësaj çështje, kërkon vëmendje të veçantë për të shqyrtuar të gjithë dokumentacionin relevant dhe për të bërë analizat në përputhje me dokumentacionin dhe me pretendimet e shprehura këtu. Kjo do të thotë që për ne është e vështirë që të mblidhemi tani dhe në harkun e gjysëm, apo një ore të japim vendimin. Ne kemi nevojë që të marrim kohë dhe vëmendje dhe të bëjmë një konsultë të detajuar për secilin rast dhe për secilën fletë, apo copë letre që kemi në dispozicion. Kështu që vendimin do ta shpallim në datën 28 qershor 2024, ora 11:00. Kjo kohë do të na duhet se kjo është një çështje jo e vogël, por e madhe, është masive. Ju falenderoj të gjithëve ju, që ishit këtu sot dhe na ndihmuat ta shqyrtojmë këtë çështje dhe KQZ-në që na u përgjigj me detaje të gjitha pyetjeve që kishim. Takimin e kemi me datën 28, seancën për sot e mbylлим, mirupafshim!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

